REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 099/26 Dt. 05.03.2026

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 shkronja b, d dhe g të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), nenit 24 paragrafi 5 i Ligjit nr. 08/L-255 për Shërbime Sociale dhe Familjare, nenit 5 të Rregullores MD-nr. 13/2024 për Organizimin dhe Funksionimin e Panelit për Strehim Rezidencial dhe neni 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643, të datës 15.10.2008, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M
Për formimin e Panelit për Strehim Rezidencial në Komunën e Prizrenit

1. Themelohet dhe emërohet Paneli për Strehim Rezidencial në Komunën e Prizrenit. Anëtarë të këtij Paneli emërohen:

   1.1. Qëndrim Berisha, ...kryesuese,
   1.2. Muhamet Shala,..... anëtare,
   1.3. Bashkim Rakaj,.....anëtar.

2. Detyrat e Panelit për Strehim Rezidencial, të emëruar si në pikën 1 e këtij Vendimi, janë të parapara në Ligjin nr. 08/L-255 për Shërbime Sociale dhe Familjare, Rregulloren MD-nr. 13/2024 për Organizimin dhe Funksionimin e Panelit për Strehim Rezidencial, si dhe aktet tjera ligjore dhe nënligjor në fuqi që e rregullojnë këtë lëmi.

3. Mandati i Panelit, të cekur si në pikën 1 të këtij Vendimi do të jetë 3 vjet, konform nenit 6 të Rregullores MD-nr. 13/2024 për Organizimin dhe Funksionimin e Panelit për Strehim Rezidencial.

4. Me këtë Vendim shfuqizohet Vendimi nr. 01 nr. 625/23, i datës 21.09.2023.

5. **Këshillë Juridike:** Kundër këtij Vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës në Shërbimin Civil, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

6. Obligohet Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Paneli i lartcekur për zbatimin e këtij vendimi.

7. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

➢ Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale,
- Panelit të lartcekur,
- Arkivës së Kryetarit.